



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 14	2001	Prill
---------------	-------------	--------------

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8750 datë 26.3.2001	Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope.....	391
Ligj nr.8751 datë 26.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8292, datë 25.2.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”	398
Ligj nr.8752 datë 26.3.2001	Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës	400
Ligj nr.8753 datë 26.3.2001	Për një shtesë në ligjin nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8361, datë 1.7.1998, nr.8421, datë 28.10.1998 dhe nr.8452, datë 28.1.1999	404
Vendim i KM Nr.158, datë 22.3.2001	Për strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të Qendrës së Publikimeve Zyrtare.....	405
Vendim i KM Nr.174, datë 30.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.....	408
	Ndreqje gabimi	409

L I G J
Nr.8750, datë 26.3.2001

**PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN NDAJ TRAFIKUT TË SUBSTANCAVE
NARKOTIKE OSE PSIKOTROPE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj përcakton normat për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope, si dhe të përdorimit të paligjshëm të substancave kimike bazë e të prekursorëve, që përdoren për prodhimin e substancave të sipërpërmendura.

Neni 2

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Blerje e stimuluar” kuptohet rasti kur oficeri ose agjenti i Policisë Gjyqësore, i zyrës së luftës kundër drogës ose një personi i autorizuar prej tyre blen substanca narkotike ose psikotrope, substanca kimike bazë, prekursorë, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose cilësinë e tij si punonjës policie.

2. “Dorëzim i kontrolluar” kuptohet veprimtaria e karakterizuar nga përdorimi i metodave gjurmuese-hetimore, për të lejuar kalimin në territorin e një ose më shumë shteteve të substancave narkotike ose psikotrope, të prekursorëve ose substancave të tjera zëvendësuese të tyre, të dërguara në mënyrë të paligjshme, të cilat mbahen nën kontrollin e autoriteteve policore të vendeve të sipërpërmendura për të identifikuar personat e përfshirë në kryerjen e veprave penale, të parashikuara në paragrafin e parë të nenit 3 të Konventës së Vjenës të vitit 1988, si dhe në ligjin shqiptar.

3. “Kultivim” kuptohet veprimtaria e kryer për prodhimin e bimëve që përmbajnë substanca narkotike ose psikotrope, ose që mund të përdoren për nxjerrjen e substancave narkotike ose psikotrope.

4. “Prekursor” kuptohet substanca e nevojshme, që përdoret për prodhimin e substancave narkotike ose psikotrope; ajo vetë bëhet pjesë e molekulës së prodhimit përfundimtar. Prokursorë janë ata që përcaktohen nga tabelat A dhe B, që i bashkëlidhen këtij ligji. Tabelat integrohen, modifikohen dhe azhurnohen nga Ministria e Shëndetësisë.

5. “Punonjës i policisë i infiltruar” kuptohet oficeri ose agjenti i Policisë Gjyqësore, i shërbimit të luftës kundër drogës ose një person i autorizuar prej tyre, i cili, për një hetim të Policisë Gjyqësore, futet në brendësi të një organizate kriminale, për të individualizuar pjesëtarët e organizatës dhe për të mbledhur prova në ngarkim të tyre, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose cilësinë si punonjës policie.

6. “Punonjës i policisë nën mbulim” kuptohet oficeri ose agjenti i Policisë Gjyqësore, pjesëtar i shërbimit të luftës kundër drogës ose personi i autorizuar prej tyre, që merr pjesë në përdorimin e metodave të "blerjes së stimuluar" e "dorëzimit të kontrolluar", duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose cilësinë e tij si punonjës policie.

7. “Substancë narkotike ose psikotrope” kuptohet çdo substancë, qoftë me origjinë natyrore ose sintetike, që figuron në tabelat I, II, III të ligjit nr. 7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope". Tabelat modifikohen, integrohen dhe azhurnohen nga Ministria e Shëndetësisë.

8. “Tabelë” kuptohet lista e hartuar për substancat për të cilat bëhet fjalë në nenin 1.

9. “Trafik i paligjshëm” kuptohet tërësia e veprimeve dhe e mosveprimeve të përcaktuara në

pjesën e Kodit Penal që trajton veprimtaritë e paligjshme në fushën e drogës.

Neni 3

Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit

Krijohet Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Luftës Kundër Drogës, nën drejtimin e Kryeministrit.

Në përbërje të këtij Komiteti janë: Ministri i Rendit Publik, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Punëve dhe Çështjeve Sociale, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror.

Komiteti mbledhet të paktën 2 herë në vit dhe ka për detyrë të përcaktojë drejtimet e politikës së përgjithshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të parandalimit dhe të luftës kundër prodhimit e përhapjes së paligjshme të substancave të sipërpërmendura, të promovojë fushata për të bërë të njohura efektet negative të drogës, masat e parandalimit, asistencën shëndetësore dhe të dhënat epidemiologjike dhe statistikore, rehabilitimin dhe integrimin e toksikodipendentëve. Komiteti administron sistemin e mbledhjes së të dhënave kombëtare, që lidhen me aspekte të luftës ndaj drogës, të cilat jepen çdo vit nga secila ministri.

Në mbledhjet e këtij Komiteti mund të thirren për të marrë pjesë edhe ministra të tjerë, si dhe specialistë të fushave të ndryshme.

Për realizimin e veprimtarisë së tij, Komitetit Kombëtar i Bashkërendimit ka një sekretari, drejtuesi i së cilës emërohet nga Kryeministri, i cili merr pjesë në mbledhjet e Komitetit.

Sekretaria përbëhet nga një staf i përhershëm specialistësh, që përcaktohen nga ministrinë, anëtare të këtij Komiteti.

Neni 4

Pranë Këshillit të Ministrave krijohet Zyra e Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën, e cila është në varësi të drejtuesit të Sekretarisë së Komitetit Ndërmintor të Bashkërendimit.

Zyra kryen përpunime dhe analiza për:

- a) përbërjen e popullsisë që përdor drogën me referim tipologjinë e substancave të përdorura;
- b) zonat e kultivimit, burimet dhe rrugët e trafikut të brendshëm e ndërkombëtar të substancave narkotike ose psikotrope dhe të prekursorëve;
- c) veprimtaritë e kryera dhe rezultatet e arritura nga forcat e policisë në luftën kundër kultivimit, trafikut dhe parandalimit;
- ç) numrin dhe përfundimet e proceseve penale për krimet në fushën e drogës;
- d) numrin e personave të denoncuar për krime në fushën e drogës të kryera në Shqipëri dhe jashtë nga shtetas shqiptarë;
- dh) vendndodhjen dhe funksionimin e shërbimeve publike e private, që veprojnë në sektorin e parandalimit, të kurimit dhe të rehabilitimit të personave përdorues të drogës, numrin e subjekteve të rehabilituara dhe që janë përfshirë në veprimtari pune, si dhe tipin e trajtimit të përdorur;
- e) numrin e subjekteve juridike e fizike, të autorizuar për prodhimin, shitjen, eksportimin dhe importimin e substancave narkotike ose psikotrope dhe të prekursorëve;
- ë) nismat e ndërmarra nga nivele të ndryshme institucionale në fushën e të dhënave, të planifikimit të programeve për parandalimin dhe luftën ndaj drogave;

Zyra ia paraqet rezultatet e punës së vet Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit.

Zyra shfrytëzon të dhënat statistikore që i jepen nga qendrat e regjistrimit të këtyre të dhënave pranë çdo ministrie.

Neni 5

Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit, nëpërmjet Kryeministrit, brenda datës 30 mars të çdo viti i paraqet Kuvendit një relacion me të dhënat që kanë të bëjnë me paraqitjen e dukurisë së drogës në

Shqipëri, me strategjitë e përshtatura, me objektivat e arritura dhe orientimet e ardhshme të Qeverisë për detyrimet ndërkombëtare.

Kryeministri çdo 3 vjet thërret një konferencë kombëtare për problemet e drogës dhe për parandalimin e luftës ndaj kultivimit e trafikut të paligjshëm.

Në të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve publike dhe të organizatave joqeveritare, të cilat kanë objekt të veprimtarisë së tyre parandalimin dhe riaftësimin e përdoruesve të drogës.

Neni 6

Shërbimi i luftës kundër drogës

Shërbimi i luftës kundër drogës përbëhet nga Shërbimi Qendror në Drejtorinë e Policisë Kriminale dhe zyrat rajonale të luftës kundër drogës në përbërje të drejtorive të policisë në qarqe.

Shërbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës (SHQLKD) është organi qendror përgjegjës për trajtimin në mënyrë të unifikuar të veprimtarisë së policisë, që ka të bëjë me parandalimin dhe luftën kundër veprave penale në fushën e drogës.

Neni 7

Për përmbushjen e detyrave të saj SHQLKD-ja informohet me të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e policisë në fushën e drogës, si dhe bashkërendon me Policinë Gjyqësore në këtë fushë.

Bashkërendimi i punës me Policinë Gjyqësore rregullohet me akte nënligjore të përbashkëta të Ministrit të Rendit Publik dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 8

Punonjësit e SHQLKD-së kanë përkatësisht atributet e oficerit dhe të agentit të Policisë Gjyqësore në të gjithë vendin.

Punonjësit e zyrave rajonale të luftës kundër drogës kanë atributet e oficerit ose agentit të Policisë Gjyqësore në territorin administrativ të qarkut.

Neni 9

SHQLKD-ja, për parandalimin dhe goditjen e krimeve në fushën e drogës në nivel ndërkombëtar, mban lidhje të drejtpërdrejtë me shërbime simotra të policive të vendeve të tjera dhe me zyrën e Interpolit.

Neni 10

Ministria e Rendit Publik, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, dy ose shumëpalëshe, mund të dërgojë jashtë territorit të vendit punonjës të SHQLKD-së.

Funksionet, detyrat, përbërja dhe numri i tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

SHQLKD-ja vihet në dijeni për çdo licencë, leje ose autorizim të veçantë, të lëshuar për prodhim, eksportim, importim, përdorim, ruajtje e tregtim të substancave ose të përgatitjeve, sipas nenit 97 të ligjit nr. 7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope". Po kështu veprohet për çdo licencë dhe leje, të pezulluar ose të anuluar, sipas neneve 27 dhe 38 të po këtij ligji.

Neni 12

Në rastet e mbërritjeve të ngarkesave me substanca narkotike ose psikotrope që eksportohen,

importohen ose tranzitohen në mënyrë të ligjshme, Policia Kufitare dhe doganat duhet të njoftojnë menjëherë Ministrinë e Shëndetësisë dhe SHQLKD-në.

Neni 13

Shërbimi i luftës kundër drogës përdor metodën e “blerjes së stimuluar” me qëllim grumbullimin e provave, identifikimin e arrestimin e personave të përfshirë në trafikun e drogave. Kjo realizohet drejtpërdrejt nga punonjësit e këtij shërbimi ose nëpërmjet personave të tjerë, që veprojnë sipas udhëzimeve të tyre.

Në të gjitha rastet “blerja e stimuluar” bëhet me autorizimin e Prokurorit të Përgjithshëm, të prokurorit që ka filluar procedimin penal ose të prokurorit që kanë në juridiksion territorin ku do të zhvillohet ky veprim.

Shpenzimet e blerjes përballohen nga fondi i veçantë që shfrytëzon Policia Kriminale me miratimin e SHQLKD-së.

Neni 14

Shërbimi i luftës kundër drogës përdor metodën e “dorëzimit të kontrolluar” për të grumbulluar prova dhe për të identifikuar autorët e veprave penale në këtë fushë, shkallën e përfshirjes së tyre dhe rolin që ka çdo pjesëmarrës në këtë veprimtari kriminale.

“Dorëzimi i kontrolluar” bëhet me autorizimin e Prokurorit të Përgjithshëm, të prokurorit që ka filluar procedimin penal ose të prokurorit që ka në juridiksion territorin ku është zbuluar prania e substancave narkotike e psikotrope ose të prekursorëve.

“Dorëzimi i kontrolluar” mund të jetë i brendshëm, në hyrje, në dalje ose tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në rastet kur “dorëzimi i kontrolluar” është tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë, SHQLKD-së i jepet autorizim nga Prokuroria e Përgjithshme dhe SHQLKD-ja ia komunikon këtë fakt shërbimeve simotra të shteteve të interesuara.

Në rastet e urgjencës së veçantë, SHQLKD-ja dhe zyrat rajonale të luftës kundër drogës mund të fillojnë me nismën e tyre përdorimin e metodës së “dorëzimit të kontrolluar”, por pasi të kenë njoftuar prokurorin, i cili mund të vendosë edhe ndryshe.

Në rastet e “dorëzimit të kontrolluar” të brendshëm, bashkërendimi ndërmjet zyrave rajonale të luftës kundër drogës sigurohet nga SHQLKD-ja.

Kur “dorëzimi i kontrolluar” është në dalje të territorit shqiptar, SHQLKD-ja duhet të sigurojë, paraprakisht, miratimin e zyrës së shtetit, ku duhet të mbërrijnë substancat. Kur vendet e interesuara janë më shumë se një, duhet miratimi i të gjithë këtyre akteve.

Shpenzimet për realizimin e dorëzimit të kontrolluar mbulohen nga Drejtoria e Policisë Kriminale.

Neni 15

Shërbimi i luftës kundër drogës përdor metodën e “punonjësit të policisë nën mbulim” dhe “të infiltruar”.

Punonjësit e Shërbimit të luftës kundër drogës ose persona të autorizuar prej tyre, të cilët marrin pjesë në veprimet e “blerjes së stimuluar” dhe “të dorëzimit të kontrolluar” ose në veprimtari të tjera, pajisjen me dokumente identifikimi, të cilat përmbajnë gjeneralitete të pavërteta.

Në rast, kur si pasojë e kësaj veprimtarie, iu kërcënohet jeta, familja ose prona, për këta punonjës zbatohen masa të mbrojtjes së veçantë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Për të siguruar të dhëna, si dhe për identifikimin e autorëve në trafikun e drogës, punonjësit e SHQLKD-së, në cilësinë e oficerit e agentit të Policisë Gjyqësore, kanë të drejtë të bëjnë interceptime të bisedave dhe të komunikimeve me mjete teknike e shkencore, të bëjnë vëzhgime, fotografime e filmime sekrete, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 17

Në përputhje në nenin 40 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, SHQLKD-ja për parandalimin dhe luftën e trafikut të paligjshëm të substancave narkotike ose psikotrope mund të vendosë të kryhen inspektime dhe kontrole mbi mjetet e transportit, mbi persona dhe bagazhet e tyre, mbi mallrat në mjediset publike dhe tregtare, në lokalet e lojërave të fatit dhe në ndërtesa ku ka dyshime të bazuara se kryhet ose është duke u kryer veprimtari kriminale në fushën e drogës.

Neni 18

Kur ka dyshime të bazuara se një person në hyrje ose tranzitim në kufirin shqiptar fsheh në trup substanca narkotike ose psikotrope, oficerët e Policisë Gjyqësore procedojnë pa autorizim paraprak, duke bërë kontrollin fizik, në përputhje me nenin 40 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Kur kontrolli fizik nuk është i mjaftueshëm, oficerët e Policisë Gjyqësore urdhërojnë kryerjen e ekzaminimeve mjekësore mbi atë person, pasi të kenë marrë pëlqimin me shkrim të tij.

Në rast mospranimi, oficerët e Policisë Gjyqësore i bëjnë kërkesë me shkrim organit të prokurorisë, i cili mund të autorizojë kryerjen forcërisht të ekzaminimeve mjekësore.

Neni 19

Drejtimi i automjeteve ose mjeteve të tjera të transportit, nën veprimin e përdorimit të substancave narkotike ose psikotrope, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Testet dhe ekzaminimet, për të zbuluar nëse një drejtues i mjeteve të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni është nën ndikimin e këtyre substancave, kryhen sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 18 të këtij ligji.

Neni 20

Veprimet e parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, kur kryhen gjatë përdorimit të metodave të “blerjes së stimuluar”, “dorëzimit të kontrolluar” dhe “infiltrimit” ose kur janë të autorizuar nga organi përkatës gjyqësor, në kuadër të një procedimi penal të filluar, vlerësohen prova dhe paraqiten në gjykatë.

Neni 21

SHQLKD-ja kur ka të dhëna të vërtetuara se pasuria e një personi është me prejardhje nga kryerja e veprave penale në fushën e drogës, me autorizim të prokurorisë heton mbi këto të ardhura dhe pasuri të çdo lloji.

Neni 22

Pasuritë e sekuestruara gjatë veprimeve antidrogë të policisë, pas konfiskimit i jepen në pronësi Policisë së Shtetit, me kërkesën e saj.

Neni 23

Personi përdorues i substancave narkotike ose psikotrope që hetohet në gjendje arresti në burg ose që vuan dënimin në burg, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 24

Personat që bashkëpunojnë në mënyrë të fshehtë ose të hapur me SHQLKD-në janë nën mbrojtjen e veçantë të shtetit. Kur për shkak të këtij bashkëpunimi u kërcënohet jeta, familja e prona

merren në mbrojtje të veçantë.

Mënyra e realizimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Në rast se personi që bashkëpunon me SHQLKD-në vritet për shkak të këtij bashkëpunimi, shteti i siguron familjes ndihmë financiare të menjëhershme.

Masa e ndihmës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kur për shkak të këtij bashkëpunimi bëhet i paaftë për të punuar, trajtohet sipas kritereve të përcaktuara në ligj.

Neni 26

Të dhënat, që lidhen me identitetin ose punën që ka bërë personi, i cili bashkëpunon ose ka bashkëpunuar në mënyrë të fshehtë me SHQLKD-në, përbëjnë sekret.

Neni 27

Personat që ndihmojnë me të dhëna ose në mënyra të tjera për zbulimin e krimeve me objekt drogën, si dhe për zbulimin dhe kapjen e autorëve, shpërblehen sipas kritereve të përcaktuara me akte nënligjore.

Dhënia e shpërblimit nuk u jepet personave që i kanë kryer vetë këto krime ose kanë bashkëpunuar për kryerjen e tyre.

Neni 28

Asgjësimi i substancave narkotike ose psikotrope të sekuestruara

Në të gjitha rastet kur substancat narkotike ose psikotrope nuk shërbejnë më për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, gjykata urdhëron asgjësimin e tyre.

Asgjësimi i tyre bëhet në prani të prokurorit, të oficerit të Policisë Gjyqësore dhe të personit të autorizuar nga gjykata. Për dokumentimin e këtij veprimi mbahet procesverbal në tri kopje.

Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rendit Publik dhe Prokuroria e Përgjithshme hartojnë rregulloren e përbashkët për ruajtjen, administrimin dhe teknikat e asgjësimit të substancave narkotike ose psikotrope të sekuestruara.

Në të gjitha rastet e sekuestrimit të bimëve narkotike të kultivuara, asgjësimi i tyre bëhet me procesverbal në vendin ku janë zbuluar, duke mbajtur mostra të bimëve narkotike për ekspertim.

Kur substancat narkotike ose psikotrope janë barna të përdorshme (me konfeksion të rregullt dhe të paskaduara), ato nuk asgjësohen, por i kalojnë në administrim Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 29

SHQLKD-ja i kërkon gjykatës marrjen e mostrave të substancave narkotike ose psikotrope të nevojshme për kryerjen e veprimeve policore dhe për stërvitjen e qenve të drogës, duke motivuar arsyen e kësaj kërkesë.

Ministria e Shëndetësisë i kërkon gjykatës nëpërmjet SHQLKD-së mostrat e nevojshme të substancave narkotike ose psikotrope për arsye studimore e shkencore.

Mënyra e asgjësimit të mostrave përcaktohet në rregulloren e përbashkët, sipas paragrafit të tretë të nenit 28.

Neni 30

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministri i Rendit Publik, Ministri i Shëndetësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm të nxjerrin akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 31

Të gjitha aktet ligjore e nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 32

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2963, datë 9.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

TABELAT E PREKURSORËVE

Tabela A Tabela B

Acid N-acetilantranilik Anhidrid acetik

Efedrinë Aceton

Ergometrinë Acid antranilik

Ergotaminë Eter etil

Izosofole Acid hidroklorik

Acid lisergjik Metil etil ketonë

3,4-metilenedioksifenil-2-propanonë Acid fenilacetik

1-fenil-2-propanonë Piperidinë

Piperonal Permagant potasi

Pseudoefedrinë Acid sulfurik

Safrole Toluenë

Kripërat e lëndëve të renditura në këtë Kripërat e lëndëve të renditura në këtë

Tabelë kudo që ekzistenca e këtyre tabelë kudo që ekzistenca e këtyre

kripërave është e mundur. kripërave është e mundur (kripërat e

acidit hidroklorik dhe të acidit

sulfurik janë përjashtuar në mënyrë

të veçantë).

L I G J
Nr.8751, datë 26.3.2001

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8292, DATË 25.2.1998 “PËR
FORCAT SPECIALE DHE ATO TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË”**

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr.8292, datë 25.2.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

“Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë janë struktura të specializuara të Policisë së Shtetit, të krijuara për të realizuar misione ndërhyrjeje dhe sigurimi, ekzekutimi i të cilave kërkon personel të përgatitur dhe të pajisur në mënyrë të posaçme.”

Neni 2

Neni 3 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si vijon:

“Pjesëmarrësve të Forcave Speciale u garantohet fshehtësia e identitetit gjatë ndërhyrjes dhe pas saj.

Fshehtësia e identitetit u garantohet edhe Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, kur veprojnë në operacione si Forcat Speciale ose në ndihmë të tyre.”

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë janë forca të gatshme të Policisë së Shtetit.

Veprimtaria e këtyre forcave shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si vijon:

“Aktivizimi në shërbime i Forcave Speciale dhe i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në raste të veçanta, kur kërkohet përdorimi masiv i këtyre forcave, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit merr miratimin me shkrim të Ministrit të Rendit Publik.

Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë përdorin armë zjarri, mjete dhe pajisje të posaçme për përmbushjen e detyrave të caktuara nga ky ligj.”

Neni 6

Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Detyrat funksionale të Forcave Speciale janë:

- Lirimi i pengjeve në kushtet e sigurisë më të lartë.
- Ndërhyrja kryesisht në mjedise urbane për ndalimin, arrestimin, neutralizimin e personave pjesëtarë të organizatave terroriste e kriminale, të bandave të armatosura, si dhe të çdo personi tjetër të armatosur ose që ka kryer një krim me armë.
- Ndihma ndaj popullatës në raste fatkeqësish të rënda natyrore e aksidentale, vetëm kur kjo është mundësia e vetme për shpëtimin e jetës së njerëzve.”

Neni 7

Neni 8 ndryshohet si vijon:

“Detyrat funksionale të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë janë:

- Sigurimi i rendit gjatë veprimtarive masive publike, në raste fatkeqësish të rënda natyrore dhe fatkeqësish të tjera, të cilat mund të shoqërohen me prishje të rendit.
- Sigurimi i rendit në akset rrugore kombëtare në rastet kur në to ka veprimtari të bandave e grupeve të armatosura.
- Marrja në ruajtje e objekteve të rëndësishme shtetërore dhe social-ekonomike, kur ka të dhëna për sulme me armë ose pa armë ndaj tyre, në qoftë se forcat e caktuara për këtë qëllim nuk janë në gjendje t’i ruajnë.
- Shoqërimi i personave të rrezikshëm në gjykata, burgje, dhoma paraburgimi, kur ka të dhëna për përpjekje për lirin e tyre.
- Ndërhyrja për rivendosjen e rendit të prishur nga akte të rënda dhune në të gjitha mjediset publike, kur forcat e policisë vendore nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë.
- Ndërhyrja për ndalimin, arrestimin e personave të shpallur në kërkim ose që ndiqen nga policia, grupeve kriminale, bandave të armatosura, kryesisht në zona rurale, kur policia vendore nuk është në gjendje t’i kryejë vetë këto.
- Ndërhyrja për rivendosjen e gjendjes normale në burgje e dhoma paraburgimi në raste rebelimi masiv të të burgosurve.
- Ndërhyrja e operacioneve në ndihmë të popullatës në rastet e fatkeqësive të rënda natyrore dhe fatkeqësive të tjera.”

Neni 8

Neni 10 ndryshohet si vijon:

“Pranimi në Forcat Speciale dhe në ato të Ndërhyrjes së Shpejtë bëhet sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe sipas kritereve të veçanta të përcaktuara në akte nënligjore.”

Neni 9

Neni 12 shfuqizohet.

Neni 10

Neni 13 ndryshohet si vijon:

“Punonjësve të Forcave Speciale dhe atyre të Ndërhyrjes së Shpejtë, kur kërcënohen për shkak të detyrës, u sigurohet mbrojtje e veçantë e jetës, familjes dhe pronës, në përputhje me kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 11

Kudo ku në ligj përdoren fjalët “Ministria e Brendshme” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Rendit Publik”.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2952, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8752, datë 26.3.2001

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE MBROJTJEN E TOKËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë strukturat pranë organeve të qeverisjes vendore për ruajtjen dhe administrimin e tokës.

Neni 2

Në zbatim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrim” kuptohen proceset e përcaktimit, të dokumentimit dhe të propagandimit të të dhënave për pronësinë, për vlerën dhe përdorimin e tokës gjatë vënies në zbatim të politikave të menaxhimit të saj.

2. “Menaxhim” kuptohen veprimtaritë e lidhura me përdorimin e tokës si një burim me vlera mjedisore dhe ekonomike.

3. “Kadastër shumëqëllimshme” kuptohet një regjistër që përfshin shumë attribute të parcelave të tokës.

4. “Tokë” ka të njëjtin kuptim si toka bujqësore në ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.

5. “Tokë pyjore dhe pyll” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7623, datë 13.10.1995 “Për pyjet dhe Policinë Pyjore”.

6. “Kullotë dhe livadh” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7917, datë 13.4.1995 “Për kullotat dhe livadhet”.

7. “Breg” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”.

8. “Varësi teknike” kuptohet detyrimi i strukturave të përcaktuara në këtë ligj për të zbatuar aktet nënligjore të miratuara nga organet eprorë.

9. “Të dhëna përshkruese” kuptohen libra ngastrash dhe regjistra të ndryshëm.

10. “GIS” është Sistemi i Informacionit Gjeografik.

11. “Tokë e pafrytshme” kuptohet toka cilësisht e dobët që nuk përfshihet në zërat kadastralë: tokë bujqësore, tokë pyjore, pyje, kullota, livadhe e troje.

12. “Mbrojtje toke” kuptohet mbrojtja fizike dhe e pjellorisë së tokës nga erozioni, ndotja dhe degradimi.

KREU II ORGANIZIMI

Neni 3

Për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, pranë Këshillit të Qarkut krijohet Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës si funksion i deleguar i Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Numri i punonjësve dhe mënyra e funksionimit të Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Përgjegjësi i Seksionit dhe specialistët emërohen dhe shkarkohen në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”.

Neni 6

Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës, si funksion i tyre sipas përcaktimit në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në çdo komunë dhe/ose bashki ngrihet zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës.

Neni 7

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në bashki dhe/ose komunë kanë varësi teknike nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit nxjerr akte nënligjore në zbatim të këtij ligji për drejtimin metodik dhe teknik të administrimit dhe menaxhimit të tokës, si dhe kontrollon zbatimin e tyre.

Neni 8

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në bashki dhe/ose komunë për realizimin e detyrave të ngarkuara nga ky ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, përgjigjen përkatësisht para Këshillit të Qarkut, Këshillit të Komunës ose Bashkisë.

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark bashkëpunon dhe shkëmben të dhëna me seksionin ose zyrën e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki.

KREU III OBJEKTI DHE FUNKSIONET

Neni 9

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark, administron dhe merr masa për mbrojtjen e tokës brenda ndarjes administrative territoriale të qarkut, siç përcaktohet në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 10

Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës menaxhon dhe merr masa për mbrojtjen e tokës në territorin brenda ndarjes administrative territoriale të komunës dhe/ose bashkisë.

Neni 11

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark dhe zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki kanë në administrim:

- a) tokat bujqësore shtetërore, që me ligj i vihen në administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë;
- b) tokat bujqësore private;
- c) pyjet komunale dhe private;
- ç) kullotat komunale dhe private;
- d) tokat pyjore shtetërore, që me ligj i vihen në administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë;
- dh) brigjet e lumenjve, që me ligj i vihen në administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë;
- e) tokat urbane të fshatit;
- ë) tokat e pafrytshme.

Neni 12

Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut për tokat që ka nën administrim, si kadastër shumëqëllimshme, kryen këto funksione:

- a) Bën planifikimin e përdorimit të tokës, ndryshimin ndërmjet zërave kadastralë dhe drejton hartimin e planeve të zhvillimit.
- b) Në bashkëpunim me institucionet e specializuara përgatit, ruan dhe azhurnon informacionin gjeografik në format e hartave, të dhënave përshkruese dhe GIS.
- c) Organizon dhe merr masa në bashkëpunim me komunat dhe bashkitë për zbatimin e programeve dhe masave mbrojtëse për ruajtjen fizike dhe të pjellorisë së tokës, nga erozioni, ndotja dhe degradimi.
- ç) Zbaton detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare dhe marrëveshjet për mbrojtjen e tokës, në të cilat vendi ynë është palë.
- d) Mban arkivin dhe regjistrat themeltarë, jep të dhëna dhe kryen veprime në shërbim të personave fizikë dhe juridikë.
- dh) Bën vlerësimin e tokës bujqësore, pyjore, pyjeve, livadheve dhe kullotave që do të shërbejnë për qëllime shpronësimi, taksa e tatime.

Mënyrat e ushtrimit të funksioneve të parashikuara në këtë nen përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Seksioni ose zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës kryen këto funksione:

- a) Përgatit procedurën dhe ia paraqet për miratim këshillit të komunës dhe/ose bashkisë për qiradhënien, dhënien me koncension, lejeve të shfrytëzimit ose formave të tjera të transferimit të të drejtave të parashikuara me akte ligjore e nënligjore të pyjeve dhe kullotave komunale, të tokave bujqësore shtetërore, tokave pyjore, brigjeve të lumenjve, që me ligj i kalojnë në pronësi ose administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë.
- b) Grumbullon informacionin gjeografik dhe ruan hartat dhe dokumentacionin që ka në varësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- c) Merr masa mbrojtëse për ruajtjen fizike dhe të pjellorisë së tokës nga erozioni, ndotja dhe degradimi.

Mënyrat e ushtrimit të funksioneve të parashikuara në këtë nen përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

SANKSIONE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Mosmarrja e masave mbrojtëse ose moszbatimi i tyre për dëmtimet fizike, për dëmtimet e pjellorisë nga erozioni, ndotja dhe degradimi, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri 50 000 lekë nga specialisti i mbrojtjes së tokës në seksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark, në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, pa përfshirë vlerën e dëmit.

Neni 15

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të kryetari i këshillit të qarkut, i cili shqyrton ankesën dhe jep vendimin brenda 5 ditëve.

Neni 16

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të vendimit bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

Neni 17

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 4, 12 dhe 13 të këtij ligji.

Neni 18

Nenet 17, 20 dhe 24 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2953, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8753, datë 26.3.2001

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7602, DATË 9.9.1992 “PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8361, DATË 1.7.1998, NR.8421, DATË 28.10.1998 DHE NR.8452, DATË 28.1.1999

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Në nenin 2 shkronja “b” të ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet e mëvonshme:

- te togfjalëshi “dhe Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë” hiqet lidhësja “dhe”;
- pas fjalëve “Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë” shtohen fjalët “dhe Kryetarin e Bashkisë së Tiranës.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2954, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.158, datë 22.3.2001

**PËR STRUKTURËN, ORGANIKËN DHE NIVELIN E PAGAVE TË QENDRËS SË
PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 24, të ligjit nr.8502, datë 30.6.1999, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare” dhe të neneve 2 dhe të 6, ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe organika e Qendrës së Publikimeve Zyrtare të jetë sipas lidhjeve nr.1 dhe nr.2 që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e institucioneve buxhetore” bëhen këto shtesa:
 - a) Lidhja nr.II-24, “Niveli i pagave për punonjësit e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - b) Në lidhjen nr.I, “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” shtohen këto emërtime:
Në shkronjën B2, “Drejtor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare”.
Në shkronjën B3, “Kryeredaktor në Qendrën e Publikimeve Zyrtare”.
Në shkronjën C2, “Korrektor gjuhësor, informaticien, në Qendrën e Publikimeve Zyrtare”.
 - c) Në lidhjen II-A në kreun II “Shtesa të tjera”, pas numrit rendor 23 shtohet numri rendor 24 me këtë përmbajtje:
“Përgjegjës i sektorit të teknikës, offsetist, teknik shtypshkronje dhe faqosës në Qendrën e Publikimeve Zyrtare, 40 për qind.
3. Efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga fondet buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2001.
4. Vendimi nr.484, datë 21.10.1999, i Këshillit të Ministrave “Për strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISRI
Ilir Meta

LIDHJA 2
ORGANIKA E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. Drejtori1
2. Redaksia(7)
Kryeredaktor1
Redaktor për Fletoren Zyrtare1
Redaktor për literaturën juridike dhe përmbledhëset e legjislacionit1
Redaktor për revistën “Drejtësia” dhe informacionin1
Redaktor për indeksin1
Korrektor gjuhësor2
3. TEKNIKA(14)
Përgjegjës i sektorit të teknikës (inxhinier mekanik/elektronik)1
Informaticien1
Offsetist3
Teknikë shtypshkronje6
Magaziner1

Faqosës2
 4. DEGA E FINANCËS(6)
 Kryetar i degës së financës1
 Specialist i parë finance1
 Arkivist1
 Shofer i drejtorit1
 Shofer1
 Pastrues1
 Punonjës gjithsej në Qendrën e Publikimeve Zyrtare28

LIDHJA II-24 NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Nr. EmërtimiKlasifikimi

1. DrejtorB2
2. KryeredaktorB3
3. RedaktorB4
4. Korrektore, InformaticienC2

Nr. Emërtimi i punonjësNiveli i pagës Shtesë për funksion

Klasa

1. Përgjegjës i sektorit të teknikësX5
2. OffsetistX
3. Teknike shtypshkronje, faqosësIX

Shënim: Punonjësit e tjerë të Qendrës së Publikimeve Zyrtare paguhen sipas lidhjes II-5“Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”.

Përgjegjësi i sektorit të teknikës, informaticieni, offsetistët, faqosësit dhe teknikët e shtypshkronjës do të marrin 40% shtesë.

V E N D I M
Nr.174, datë 30.3.2001

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në lidhjen I dhe në lidhjen II-5, në shkronjën B3, shtohet emërtimi “Shef i shërbimit mjeko-ligjor” dhe në shkronjën B4 të po këtyre lidhjeve, shtohen emërtimet: “specialist mjeko-ligjor”, “specialist mjeko-ligjor psikiatër”, “specialist toksikolog”, dhe “specialist mjeko-ligjor pranë gjykatave”. Këto emërtime në lidhjen III-5/28 shfuqizohen.

2. Tabela e pagave për punonjësit e shërbimit të ekspertimit mjeko-ligjor të jetë sipas lidhjes nr.24, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në fund të paragrafit të tretë, të pikës 7, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Nuk përfitojnë nga këto shtesa mbi pagën në përqindje specialistët e shërbimit qendror të mjekësisë-ligjore dhe specialistët mjeko-ligjorë pranë gjykatave.”.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga ky vendim, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

5. Ngakohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LIDHJA NR.24
NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT QENDROR
TË MJEKËSISË LIGJORE

Nr.EMËRTIMI I PUNONJËSITKLASIFIKIMI

Klasa shtesë për

Funksion (grupi)

1. KryelaborantVII2

2. Teknik-laborantVI

Për punonjësit e tjerë të zbatohen pagat sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e Ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, të vendimit nr.726, datë 21.12.2000.

NDREQJE GABIMESH

Në Fletoren Zyrtare Nr.3, janar 2001, në faqen 87, në ligjin 8707, datë 1.12.2000:

Është Bëhet

Ligji 8707, datë 1.12.2000 Ligji 8707, datë 24.1.2001

Paragrafi “1” i nenit 3 hiqet

Paragrafi “2” “1”.

Paragrafi “3” “2”.

Fletorja Zyrtare gjendet:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 12.4.2001
Doli nga shtypi më 13.4.2001

Tirazhi: 4200 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”, Tiranë

Çmimi: 100 lekë